



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ prot.

Datë ____/____/ 2018

V E N D I M

Nr. 51 , Datë 07 / 02 / 2018

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mori në shqyrtim ankesën me nr. Regj.159, datë 16.12.2017, të znj.I. N, kundër Bashkisë Gjirokastër, me pretendimin e diskriminimit “*për shkak të ngjyrës, bindjeve politike dhe gjendjes ekonomike*”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹,

K O N S T A T O I :

Znj.I. N në ankesën e saj pranë KMD-së shprehet se: “*Eshtë zaptuar korridori i përbashkët e pallatit dhe si rrjedhojë na kanë bllokuar oxhakun dhe kabllon e korentit të banesës tonë. Ndërkohë në korridor është hapur një dritare e cila është bërë kuzhinë dhe i gjithë tymi na hyn në shtëpi. Ky person na kërkon të mos kalojmë në korridorin e përbashkët të pallatit por nga ballkoni. Jemi ankuar disa herë në Bashkinë e Gjirokastrës por nuk kemi marrë përgjigje...*”.

Për sa më sipër, ankuesja kërkon nga Komisioneri: “*1. Të kthehet korridori i përbashkët i pallatit në gjendjen e mëparëshme. 2. Të vendosen kangjellat siç kanë qenë. 3. Të na kthehet kabllonja e korentit e banesë tonë. 4. Të marrim dëmshpërblim monetar*”.

Ligji nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ofron mbrojtje nga diskriminimi. Në nenin 1 të tij përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.

Bazuar në deklaratimet e bëra nga subjekti ankues në formularin e ankesës, Komisioneri, konstaton se:

Lidhur me pretendimet e subjektit ankues që Komisioneri të mundësojë kthimin e korridorit të përbashkët të pallatit në gjendjen e mëparëshme, të vendosë kangjellat siç kanë qenë, të kthejë kabllon e korentit të banesës së tij apo ta dëmshpërblejë për dëmin e pësuar, Komisioneri e informon se këto kërkesa nuk bëjnë pjesë në kompetencat e Tij. Referuar nenit 21, pika 1 të Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin.

Lidhur me pretendimin për dëmshpërblim monetar, Komisioneri nuk ka kompetencë të dëmshpërblejë individët, por dëmshpërblimi mund të kërkohet gjyqësisht.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si *“çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*

Bazuar në nenin 33, pika 4/b/ç, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i cili citon se: *“Ankesa nuk pranohet nëse është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”*, nuk përmbushen kriteret e përcaktuara nga ky Ligj, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 33, pika 2, si dhe në nenin 33, pika 4/b/ç, të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së znj.I. N për shkak se është e papajtueshme me dispozitat e ligjit 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në gjykatë, brenda afateve ligjore.

Irma BARAKU

KOMISIONERI

Fusha: Shërbime

Shakaku: Ngjyra, bindjet politike, gjendja ekonomike